



**Oda e Stomatologëve të Kosovës**  
Stomatološka Komora Kosova  
Dental Chamber of Kosovo



**Oda e Infermierëve të Kosovës**  
Nurses Chamber of Kosova

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI MIDIS ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS DHE ODËS SË INFERMIERËVE TË KOSOVËS

### Neni 1

Oda e Stomatologëve të Kosovës dhe Oda e Infermierëve të Kosovës (në vazhdim *Palët*) shprehin vullnetin dhe mirëkuptimin për një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe të domosdoshëm për rritjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës profesionale të infermierëve dhe teknikëve dentar nëpërmjet formave të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (në vazhdim *EVP*)

### Neni 2

*Palët* bien dakord të bashkëpunojnë për të nxitur dhe mbështetur këto forma në përputhje me nevojat dhe kërkesat profesionale të infermierëve dhe teknikëve dentar si edhe për të lehtësuar e mundësuar pjesëmarrjen sa më të gjërë të tyre në këto forma.

### Neni 3

Oda e Stomatologëve të Kosovës merr përsipër organizimin e formave të ndryshme të *EVP* për infermieret dhe teknikëve dentar me qëllim që ata të mësojnë të përditësohen me teknikat më të fundit për trajtimet dhe medikamentet e reja në stomatologji.

### Neni 4

Oda e Infermierëve e Kosovës merr përsipër për të njohur format e ndryshme të *EVP* që i organizon Oda e Stomatologëve nëpërmjet akreditimit të saj.

## Neni 5

*Palët* reciprokisht do të informojnë njëra tjetrën për ecurinë e procesit të EVP, pjesëmarrjen e infermierëve dhe teknikëve dentar, problemet dhe mangësitë.

## Neni 6

*Palët* bien dakord për format e përmirësimit të mangësive të evidentuara në mbështetje dhe bashkëpunim të ndërsjelltë midis dy institucioneve.

## Neni 7

Ky memorandum lidhet për një afat të pacaktuar. *Palët* mund të bien dakord në çdo kohë për përfundimin e këtij memorandumi.

## Neni 8

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes *Palëve*.

## Neni 9

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

17 Maj 2019

Për Odën e Stomatologëve të Kosovës

Prof..Dr. Blerim Kamberi



Për Odën e Infermierëve të Kosovës

Z. Naser Krustemaj

